



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 04.05.2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Nekibe Kelmendi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për Integritet Evropian dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Jusuf Zejna – NDI, Labinot Smaraj – Ministria e Integritetit Evropian, Blerim Vela, – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Fatmir Curri dhe Mimika Loshi – KCSF, Marie Nikolla – Bota Sot dhe Arban Abrashi e Venera Mjekiqi – Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Ndarja e detyrave grupeve punuese të Komisionit, pas miratimit të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08. 04. 2011, nr. 3.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 08.04.2011 (nr. 3).

Xhavit Haliti – Tha se ka dy vërejtje për t'i paraqitur: e para ka të bëjë me vonesën dhe e dyta për mos konsultimin me nënkryetarët e Komisionit rreth rendit të ditës.

Kryesuesi u shpreh i gatshëm të marrë parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Komisionit.

3. Ndarja e detyrave të grupeve punuese të Komisionit, pas miratimit të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011;

Kryesuesi - Konstatoj se ndarja e grupeve punuese të Komisionit për Integritet Evropian, pas miratimit të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2011, do të ndihmojë në realizimin e objektivave të këtij plani që ndërlidhen me veprimet e Kuvendit të Kosovës, që duhet ndërmarr për të realizuar përmbushjen e sfidave, të cilat dalin nga Raporti i progresit për Kosovën. Është bërë një ndarje në tre grupe punuese që kanë të bëjnë kryesisht në tri fusha ose kritere të cekura në Planin e Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011 me këta anëtarë, si vijon:

Kriteret politike:

1. Xhavit Haliti;
2. Blerim Shala;
3. Sasha Milosavljeviq;
4. Suzana Novobërdaliu;
5. Vjosa Osmani.

Kriteret ekonomike:

1. Sasha Milosavljeviq;
2. Albert Kinolli;
3. Vjosa Osmani;

4. Fatmir Limaj.

Standardet evropiane:

1. Alma Lama;
2. Lutfi Haziri;
3. Blerta Deliu – Kodra;
4. Nekibe Kelmendi.

Suzana Novoberdaliu - Propozoj që në këto grupe punuese të jetë nga një udhëheqës i grupit, siç është praktikuar edhe në të kuluaren.

Kryesuesi tha se deri në qershor do të përgatitet raporti i parë për Planin e Veprimit, kurse për udhëheqës të grupeve të caktohen:

Khavit Haliti – udhëheqës i grupit për Kritere Politike,

Sasha Milosavljeviq – udhëheqës i grupit për Kritere Ekonomike, dhe

Alma Lama – udhëheqëse e grupit për Standardet Evropiane.

PËRFUNDIM

Miratohet ndarja e grupeve punuese dhe caktimi i udhëheqësve të grupeve punuese për përmbushjen e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011.

5. Të ndryshme

Kryesuesi e njoftoi Komisionin për organizimin dhe mbajtjen e një punëtorie në Durrës, të mbështetur nga KCSF. Gjithashtu e njoftoi Komisionin për organizimin e një takimi të komisionit me Ministren e Tregtisë dhe Industrisë dhe kryetarin e asociacionit të komunave.

Brenda javës do konsultohemi edhe për vizitën në Zagreb edhe Lubjanë, si dhe më 11 maj do të kemi një delegacion nga Parlamenti holandez, i cili do të takohet me Komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri